




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 422 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “EJONA” sh.p.k- Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “BF Energy&Romay Lift”–Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-19-1538-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën 29.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: OE “EJONA” sh.p.k –Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-19-1538-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ - Kuvendi i Komunës së Prishtinës .

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-19-1538-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “EJONA” sh.p.k- Pejë, aprovohet si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë (në Eprokurim) është bërë :25.03.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë: 30.04.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë: 30.04.2019.

Data e përfundimit të rivlerësimit të ofertave është bërë : 01.08.2019.

Data e njoftimit mbi vendimin e AK është bërë: 02.07.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë: 02.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim – I është bërë: 25.05.2019.

Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim- I është bërë : 30.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim – II është bërë : 06.07.2019.

Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim – II është bërë : 08.07.2019.

Operatori ekonomik ankues “EJONA” sh.p.k –Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.07.2019 me nr. 422/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit 616-19-1538-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,87 paragrafi 2, nën paragrafi 2.8, 61 paragrafi 6, 4.2, 4.4, 4.5.1, 4.5.2, 4.5.3, 4.5.4, 4.5, 4.5.5, 4.6, 4.6.2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.07.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt:29.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues konstaton :

Tenderuesi Ankues, "EJONA" sh.p.k – Pejë, deklaroi se nuk pajtohet me vendimin e publikuar nga AK, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES të datës: 02.07.2019. (AK në vendim gabim e ka shkruar muajin, me 02.08.2019 dhe në letrën standarde 01.08.2019) Mendojmë se AK ka bërë gabime gjatë vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura sipas tenderuesit ankues "EJONA" shpk Pejë janë:

1) Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 6, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Neni 61- Tenderët Jo -Normalisht të Ulët paragrafi 1, 2,5 dhe nuk është respektuar formula e eliminimit të tenderit jo normalisht të ulët sipas paragrafit 6 të këtij neni.

Ekspertja profesionale e prokurimit pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit – rivlerësimit të këtij tenderi dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lëndës së trajtuar, për shkeljet dhe pretendimet që lidhen me këto nene, sqaron me sa vijon:

1. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 61)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i -tenderuesi ankues- EJONA" shpk Pejë, se nuk është zbatuar si duhet Nenin 61 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) nga Autoriteti Kontraktues, është i bazuar, sepse në ofertën e Tenderuesit të shpallur fitues, Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. "BF ENERGY"& "Romay Lift"SH.P.K. nga Prishtina kam konstatuar se kemi të bëjmë me çmime manipulative, Jo normalisht të ulëta dhe me çmime abnormalisht të larta.

Ekspertja profesionale e prokurimit, lidhur me këtë pretendim të tenderuesin Ankues, për të sqaruar më mirë, me qëllim të ardhjes deri te çmimet e përafërta, nga 6 ofertat financiare të pranura për këtë shërbim në këtë aktivitet të prokurimit, ka analizuar dhe kalkuluar të gjitha 6 ofertat.

Për të mos u bazuar vetëm në ofertën e tenderuesit ankues, nga 6 ofertat sa kanë ofertuar është nxjerrë Çmimi mesatar për 6 oferta si vijon :

RIPARIMI DHE RREGULLIMI I ASHENSORËVE-KONTRATË KORNIZË

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar per 6 oferta	Tenderuesi I shpallur fitues 1 : BF ENERGY & Romay Lift		
					Çmimi total me TVSH €	Cmimi total i peshuar €	Poena
1	Ndërrimi i tabelave komanduese elektronike me frekuencë dhe me mundësi ndalese në kate nëse ndërpritet rryma.	copë	1	1,907.50	50.00	1.50	3
2	Ndërrimi i litarëve ø 9, 10,11,12,13 mm	m'	1	9.65	12.00	0.12	1
3	Ndërrimi i pullegjës për litar ø 9, 10,11,12,13 mm	copë	1	310.17	1.00	0.03	3
4	Ndërrimi i instalimi elektrik komandues në dhomën makinerike dhe neper etazh (kate)	etazhe	1	144.00	30.00	0.30	1
5	Ndërrimi i butonave thirrës të brendshme dhe të jashtme	copë	1	42.23	12.00	0.12	1
6	Ndërrimi i pirunëve (kontaktore) femëror dhe mashkullor	copë	1	54.50	4.00	0.04	1
7	Vendosja e dymve të brendshme (kabinës)	copë	1	328.67	4.00	0.12	3
8	Kufitaret	copë	1	42.67	3.00	0.03	1
9	Ndërrimi i reduktorit	copë	1	1,096.83	2,500.00	25.00	1
10	Ndërrimi i vajit të reduktorit	litër	1	8.33	7.00	0.07	1
11	Ndërrimi i elektromotorit me frekuencë në vend të atij me dy shpejtësi	copë	1	1,766.33	50.00	1.50	3
12	Ndërrimi i agregatit hidraulik, komplet me elektromotorin dhe pompën adekuate	copë	1	2,523.33	50.00	0.50	1
13	Ndërrimi i cilindrit për ashensorin hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionet i jashtëm definohen për porosinë	copë	1	1,225.00	30.00	0.30	1
14	Ndërrimi i pistonit për ashensorë hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionet i jashtëm definohen për porosinë	copë	1	859.33	5.00	0.05	1
15	Dyer të kabinës, automatike teleskopike-me rregullim frekuencor	copë	1	850.50	5.00	0.05	1
16	Ndërrimi i lmyesës universale për lubrifikim	copë	1	23.17	1.00	0.01	1
17	Vendosja e displejve në dyert e pusorës për qdo etazhë e cila tregon pozitën dhe kahjen e lëvizjes së ashensorit	copë	1	58.83	80.00	0.80	1
18	Riparimi i elektromotorit (mbështjellja, vinklimi)	copë	1	355.25	0.50	0.01	2

19	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i rregullatorit te litarit	copë	1	209.17	330.00	3.30	1
20	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i sistemit te frenimit	copë	1	217.17	450.00	4.50	1
21	Mekanizmi qendror për hapjen dhe mbylljen e dyerve.Cz	copë	1	90.17	5.00	0.05	1
22	Rrëshqitësit	copë	1	29.17	15.00	0.15	1
23	Furnizimi dhe montimi i kundër peshës të ashensorit me dimensione ekzistuese	copë	1	357.83	2.00	0.02	1
24	Furnizimi dhe montimi i sistemit të frenimit nën kabinën e ashensorit	copë	1	141.17	3.00	0.03	1
25	Ndërrimi i dyerve te jashtme dhe vendosja e dyerve gjysme automatike	copë	1	331.33	450.00	4.50	1
26	Ndërrimi i modulit elektronik për komandim me ashensorë	copë	1	214.05	3.30	0.03	1
27	Ndërrimi i bllokut (komplet) të dhenësit magnetik	copë	1	48.67	1.00	0.01	1
28	Riparimi i dyerve te jashtme (ndërrimi i bravave elektromagnetike, diktatoreve, amortizatorët, lyerja e derës dhe vendosja e gjamit)	derë	1	193.83	300.00	3.00	1
29	Pastrimi i kabinës, ndriçimi i saj dhe vendosja e pasqyrës	copë	1	138.33	20.00	0.20	1
30	Pastrimi i pusores dhe i dhomës makinerike	copë	1	37.17	5.00	0.05	1
31	Rregullimi i tabelës kryesore te rrymës	copë	1	158.00	260.00	2.60	1
32	Ndërrimi i ndërprerësit te fuqisë ne grupin "H"	copë	1	83.85	0.10	0.01	5
33	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i ventilatorit te elektromotorit	copë	1	84.35	0.10	0.01	5
34	Riparimi i kabinës (shtrimi i dyshemesë dhe veshja e mureve te kabinës) ne konstrukcionin e njëjte	kabinë	1	338.33	20.00	0.20	1
35	Ndërrimi i udhëzueses për lëvizjen e kabinës		1	46.42	0.50	0.01	1
36	Ndërrimi i udhëzueses për kundërpesha		1	38.02	1.10	0.02	2
37	Izolimi i kulmit të shtëpizës së ashensorit (ter letër, bitumen, zhavorr)	m²	1	148.83	10.00	0.20	2
38	Furnizimi dhe montimi i kabinës së liftit e veshur me dimensione të kabinave ekzistuese	copë	1	1,080.00	50.00	3.50	7
39	Furnizimi dhe montimi i operatorit për dyer te ashensorit me dimensionet 70 cm 80 cm 90 cm 100 cm tipi sellcom ose fermator	copë	1	655.33	2.00	0.16	8

40	Porosia dhe montimi i 4 shkarkuesëve të mbritensionit me tension të durimit deri në 500V dhe rrymë të durimit deri 5kA	copë	1	109.85	0.10	0.01	7
41	Shqyrtimi i pjesës dinamike dhe statike të ashensorëve (e cila bëhet nga kompania e licencuar)	copë	1	498.33	1,500.00	15.00	1
42	Porosia dhe montimi i binarëve të ashensorëve	m'	1	43.83	15.00	0.15	1
43	Porosia dhe montimi i tabelës emergjente	copë	1	225.00	30.00	0.30	1
44	Porosia dhe montimi i kontrollit të qasjes me kartela për Ashensorë.	komplet	1	706.67	1,500.00	15.00	1
45	Servisimi i ashensorëve, në institucione Komunale. a)vaji b)piruneve c)kontaktoreve d)butonave dhe pjesët për mirëmbajtje.	herë	1	245.00	700.00	14.00	2
46	Furnizimi ,transporti dhe montimi i ashensorit elektrik Q=430 Kg me pjesët përcjellëse të tij (set).	komplet	1	26,137.50	11,000.00	880.00	8
47	Furnizimi ,transporti dhe montimi i ashensorit hidraulik Q=430 Kg me pjesët përcjellëse të tij (set).	komplet	1	27,586.67	22,000.00	1,760.00	8
Cmimi i përgjithshëm				71,800.33	41,517.70	2,737.55	100

Nga krahasimi i ofertës së shpallur fituese me Çmimin e fituar mesatar për 6 ofertat, kam konstatuar se nga 47 artikuj në listën e çmimeve – ofertës financiare, 32 artikuj (68 %) janë me çmime jo-normalisht të ulët, shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (9, 20, 28, 31 41, 44, 45) janë me çmime abnormalisht të larta, (shiko tabelën RIPARIMI DHE RREGULLIMI I ASHENSORËVE-KONTRATË KORNIZË, më lartë).

Autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të këtij tenderi në pajtueshmëri me nenin 61 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar nga tenderuesi i shpallur fitues, për të dhënë shpjegim për çmimet e ulëta përmes Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët.

Tenderuesi i shpallur fitues, në sqarimet e dhëna për çmime jo-normalisht të ulëta, për të gjithë artikujt ka dhënë vetëm deklarata se posedojnë pjesë rezervë në depo dhe fotografi të stoqeve, kinse do të favorizohet me furnizime nga prodhuesit dhe fabrikat, pa dhënë argumente (ndonjë ofertë, profaturë nga

këta furnizues apo prodhues) se me çfarë çmime do të furnizohet, kur dihet se rabatet nga ana e prodhuesve mundën me qenë deri 10%, nuk është bashkangjitur asnjë kontratë nga tenderuesi i shpallur fitues, që është realizuar deri më tani me këto çmime jashtëzakonisht të ulëta.

Tenderuesi i shpallur fitues, me shpjegimin (arsyetimi i dhënë) për çmime jo normalisht të ulëta, se 4 nga 6 tenderët e dorëzuar kemi pasur çmime shumë të përafërta, nuk qëndron dhe i pa bazuar sepse nga kontrollimi dhe nxjerrja e mesatares së çmimeve kamë konstatuar se asnjë ofertë tjetër nuk ka këso dallime(32 artikuj (68 %) janë me çmime abnormalisht të ulët, shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (9, 20, 28, 31 41, 44, 45) janë me çmime abnormalisht të larta).

Çmimi i ofertës së tenderuesit të shpallur fitues, kuptohet është i përafërt me ofertat tjera por ka çmime abnormalisht të ulët, 32 artikuj shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (janë me çmime abnormalisht të larta).

Autoriteti Kontraktues pa të drejtë e pranon të mjaftueshëm shpjegimin (arsyetimi i dhënë) për çmime jo normalisht të ulëta, nga Tenderuesi i shpallur fitues, Grup i Operatorëve Ekonomik N .SH. “BF ENERGY”& “Romay Lift”SH.P.K. nga Prishtina dhe e trajton tenderin njëjtë me tenderët tjerë.

Nga gjithë kjo që u tha më lartë, lidhur me Nenin 61(Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), mendoj se është pasojë e vendosjes së Kriterit për Dhënie të Kontratës nga Autoriteti Kontraktues, (Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar), pa e analizuar në mënyrë të duhur natyrën e këtij shërbimi.

Me rastin e ofertimit të OE, shihet se AK nuk ja ka arritur ta vendos kriterin, në pajtueshmëri me Nenin 52.6. të LPP dhe Nenin 27. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (Kriteret e Dhënies së Kontratës), për të mundur me fituar ofertën më të volitshme me çmim më të ulët sipas poentimit-peshimit. Kjo ka ardhur për arsye AK e ka vendos çmimi të peshohet në baze të rëndësisë së secilit "artikull", por është dashtë poentimi të bëhet në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve”.

2. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve).

2.a. Pretendimi i tenderuesit ankues të 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si vijon:

2) Ne besojmë se ky Aktivitet i Prokurimit është përgatitur dhe favorizuar vetëm për një OE në këtë rast OE Fitues “BF Energy”&”Romay Lift”, pasi që duke iu referuar (neni 69 i LPP-se) i lartë cekur, kur është fjala për Referencat të cilat të gjitha janë nga blerës privat(aspak bindëse).

Ekspertja profesionale e prokurimit , konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pabazuar, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë të ngjashme, në vlerë minimale prej 150,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).
2. Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Një Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me dy vite përvojë pune pas diplomimit Një Inxhinier i diplomuar i makinerisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një listë e kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të kontratave;
2. CV, Diploma dhe marrëveshja mbi angazhim.

Referencat nga sektori privat të bashkëngjitura nga Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. “BF ENERGY”& “Romay Lift”SH.P.K. nga Prishtina, Autoriteti kontraktues i ka vlerësuar dhe janë në pajtueshmëri me nenin 69.4.2 të LPP. (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale).

4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

2 .b. Pretendimi i tenderuesit ankues te 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si vijon:

4)Ne dosje te OE te shpallur fitues shihet se OE nuk ka eksperience por as staf te certifikuar për këtë veprimtari andaj shpalljen e këtij OE fitues ne e shohim edhe si te rrezikshme për personat që do shfrytëzojnë ashensorët. Inxhinieret e prezantuar shihet ne CV-te e tyre se nuk kane eksperience ne veprimtarinë e ashensorëve.

Ekspertja profesionale e prokurimit, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pabazuar, sepse Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit”.

Vlerësimi është bërë në pajtueshmëri me nenin 69.4.2 te LPP. (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale), për pozitën Një Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes me dy vite përvojë pune pas diplomimit ka angazhuar Fahredin Bekollin dhe për Një Inxhinier i diplomuar i makinerisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit ka angazhuar Fatmir Kelmendi. Nga kontrollimi i dokumentacionit për mundësitë profesionale që të dy i plotësojnë kërkesën për përvojë pune, me dy vite përvojë pune pas diplomimit dhe janë të përgjegjshëm.

Në bazë të sqarimeve të cekura më lartë, eliminimi i kompanisë DPT,GENC“ nga Mitrovica, me arsyetimin se shpjegimi (arsyetimi i dhënë) për çmime jo normalisht të ulëta, nga ky tenderues nuk është i mjaftueshëm për Autoritetin Kontraktues, nuk qëndron e konsiderojmë te pa drejtë, i pa bazuar sepse të gjitha ofertat janë përafërsisht të njëjta, kurse nga to oferta e tenderuesit ankues DPT,GENC“ nga Mitrovica është më e lira.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e tenderuesit ankues, “EJONA” shpk nga Peja, se Autoriteti Kontraktues ka shkelur neni 61 i LPP, pasi nuk

e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, janë të qëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e Tenderuesit ankues “EJONA” shpk nga Peja të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek më lart), njëherësh propozoj që të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik “EJONA” shpk -Pejë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 31.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 01.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.08.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertës profesionale të prokurimit të OSHP-së, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se Dispozitat e shkelura nga ana e AK-se janë:

1) Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 6, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Neni 61- Tenderët Jo -Normalisht të Ulët paragrafi 1, 2,5 dhe nuk është respektuar formula e eliminimit të tenderit jo normalisht të ulët sipas paragrafit 6 të këtij neni.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit –rivlerësimit të këtij tenderi dhe

pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lëndës së trajtuar, për shkeljet dhe pretendimet që lidhen me këto nene, sqaron me sa vijon:

1. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 61)

ky pretendim i -tenderuesi ankues- EJONA” shpk Pejë, se nuk është zbatuar si duhet Nenin 61 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) nga Autoriteti Kontraktues, është i bazuar, sepse në ofertën e Tenderuesit të shpallur fitues, Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. “BF ENERGY”& “Romay Lift”SH.P.K. nga Prishtina kam konstatuar se kemi të bëjmë me çmime manipulative, Jo normalisht të ulëta dhe me çmime abnormalisht të larta.

Lidhur me këtë pretendim të OE Ankues, për të sqaruar më mirë, me qëllim të ardhjes deri te çmimet e përafërta, nga 6 ofertat financiare të pranura për këtë shërbim në këtë aktivitet të prokurimit, eksperti profesional i prokurimit ka analizuar dhe kalkuluar të gjitha 6 ofertat.

Për të mos u bazuar vetëm në ofertën e OE ankues, nga 6 ofertat sa kanë ofertuar është nxjerrë Çmimi mesatar për 6 oferta si vijon :

RIPARIMI DHE RREGULLIMI I ASHENSORËVE-KONTRATË KORNIZË							
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar per 6 oferta	Tenderuesi I shpallur fitues 1 : BF ENERGY & Romay Lift		
					Çmimi total me TVSH €	Çmimi total i peshuar €	Poena
1	Ndërrimi i tabelave komanduese elektronike me frekuencë dhe me mundësi ndalese në kate nëse ndërpritet rryma.	copë	1	1,907.50	50.00	1.50	3
2	Ndërrimi i litarëve ø 9, 10,11,12,13 mm	m'	1	9.65	12.00	0.12	1
3	Ndërrimi i pullegjës për litar ø 9, 10,11,12,13 mm	copë	1	310.17	1.00	0.03	3
4	Ndërrimi i instalimi elektrik komandues në dhomën makinerike dhe neper etazh (kate)	etazhe	1	144.00	30.00	0.30	1
5	Ndërrimi i butonave thirrës të brendshme dhe të jashtme	copë	1	42.23	12.00	0.12	1
6	Ndërrimi i pirunëve (kontaktoreve) femëror dhe mashkullor	copë	1	54.50	4.00	0.04	1
7	Vendosja e dyerve të brendshme (kabinës)	copë	1	328.67	4.00	0.12	3
8	Kufitare	copë	1	42.67	3.00	0.03	1

9	Ndërrimi i reduktorit	copë	1	1,096.83	2,500.00	25.00	1
10	Ndërrimi i vajit te reduktorit	litër	1	8.33	7.00	0.07	1
11	Ndërrimi i elektromotorit me frekuencë në vend të atij me dy shpejtësi	copë	1	1,766.33	50.00	1.50	3
12	Ndërrimi i agregat hidraulik, komplet me lektromotorin dhe pompen adekuate	copë	1	2,523.33	50.00	0.50	1
13	Ndërrimi i cilindrit për ashensorin hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionit i jashtëm definohet para porosisë	copë	1	1,225.00	30.00	0.30	1
14	Ndërrimi i pistonit për ashensorë hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionit i jashtëm definohet para porosisë	copë	1	859.33	5.00	0.05	1
15	Dyer të kabinës, automatike teleskopike-me rregullim frekuencor	copë	1	850.50	5.00	0.05	1
16	Ndërrimi i lyeses univerzale për lubrifikim	copë	1	23.17	1.00	0.01	1
17	Vendosja e displejëve në dyert e pusores për qdo etazhë e cila tregon pozitën dhe kahjen e lëvizjes së ashensorit	copë	1	58.83	80.00	0.80	1
18	Riparimi i elektromotorit (mbështjellja, vinklimi)	copë	1	355.25	0.50	0.01	2

19	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i rregullatorit te litarit	copë	1	209.17	330.00	3.30	1
20	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i sistemit te frenimit	copë	1	217.17	450.00	4.50	1
21	Mekanizmi qendror për hapjen dhe mbylljen e dyerve.Cz	copë	1	90.17	5.00	0.05	1
22	Rrëshqitësit	copë	1	29.17	15.00	0.15	1
23	Furnizimi dhe montimi i kundër peshës të ashensorit me dimensione ekzistuese	copë	1	357.83	2.00	0.02	1
24	Furnizimi dhe montimi i sistemit të frenimit nën kabinën e ashensorit	copë	1	141.17	3.00	0.03	1
25	Ndërrimi i dyerve te jashtme dhe vendosja e dyerve gjysme automatike	copë	1	331.33	450.00	4.50	1
26	Ndërrimi i modulit elektronik për komandim me ashensorë	copë	1	214.05	3.30	0.03	1
27	Ndërrimi i bllokut (komplet) të dhenësit magnetik	copë	1	48.67	1.00	0.01	1
28	Riparimi i dyerve te jashtme (ndërrimi i bravave elektromagnetike, diktatoreve, amortizatorët, lyerja e derës dhe vendosja e gjamit)	derë	1	193.83	300.00	3.00	1
29	Pastrimi i kabinës, ndriçimi i saj dhe vendosja e pasqyrës	copë	1	138.33	20.00	0.20	1
30	Pastrimi i pusores dhe i dhomës makinerike	copë	1				1

				37.17	5.00	0.05	
31	Rregullimi i tabelës kryesore te rrymës	copë	1	158.00	260.00	2.60	1
32	Ndërrimi i ndërprerësit te fuqisë ne grupin "H"	copë	1	83.85	0.10	0.01	5
33	Riparimi gjegjësisht ndërrimi i ventilatorit te elektromotorit	copë	1	84.35	0.10	0.01	5
34	Riparimi i kabinës (shtrimi i dyshemesë dhe veshja e mureve te kabinës) ne konstrukcionin e njëjte	kabinë	1	338.33	20.00	0.20	1
35	Ndërrimi i udhëzueses për lëvizjen e kabinës		1	46.42	0.50	0.01	1
36	Ndërrimi i udhëzueses për kundërpesha		1	38.02	1.10	0.02	2
37	Izolimi i kulmit të shtëpizës së ashensorit (ter letër, bitumen, zhavorr)	m²	1	148.83	10.00	0.20	2
38	Furnizimi dhe montimi i kabinës së liftit e veshur me dimensione të kabinave ekzistuese	copë	1	1,080.00	50.00	3.50	7

39	Furnizimi dhe montimi i operatorit për dyer te ashensorit me dimensionet 70 cm 80 cm 90 cm 100 cm tipi sellcom ose fermator	copë	1	655.33	2.00	0.16	8
40	Porosia dhe montimi i 4 shkarkuesëve të mbitemionit me tension të durimit deri në 500V dhe rrymë të durimit deri 5kA	copë	1	109.85	0.10	0.01	7
41	Shqyrtimi i i pjesës dinamike dhe statike të ashensorëve (e cila bëhet nga kompania e licencuar)	copë	1	498.33	1,500.00	15.00	1
42	Porosia dhe montimi i binarëve të ashensorëve	m'	1	43.83	15.00	0.15	1
43	Porosia dhe montimi i tabelës emergjente	copë	1	225.00	30.00	0.30	1
44	Porosia dhe montimi i kontrollit të qasjes me kartela për Ashensorë.	komplet	1	706.67	1,500.00	15.00	1
45	Servisimi i ashensorëve, në institucione Komunale. a)vaji b)piruneve c)kontaktoreve d)butonave dhe pjesët për mirëmbajtje.	herë	1	245.00	700.00	14.00	2
46	Furnizimi ,transporti dhe montimi i ashensorit elektrik Q=430 Kg me pjesët përcjellëse të tij (set).	komplet	1	26,137.50	11,000.00	880.00	8
47	Furnizimi ,transporti dhe montimi i ashensorit hidraulik Q=430 Kg me pjesët përcjellëse të tij (set).	komplet	1	27,586.67	22,000.00	1,760.00	8
Cmimi i pergjithshem				71,800.33	41,517.70	2,737.55	100

Nga krahasimi i ofertës së shpallur fituese me Çmimin e fituar mesatar për 6 ofertat, sipas Ekspertit profesional të prokurimit, se nga 47 artikuj në listën e çmimeve – ofertës financiare, 32 artikuj (68 %) janë me çmime jo-normalisht të ulët, shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (9, 20, 28, 31 41, 44, 45) janë me çmime abnormalisht të larta, (shiko tabelën RIPARIMI DHE RREGULLIMI I ASHENSORËVE-KONTRATË KORNIZË, më lartë).

Autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të këtij tenderi në pajtueshmëri me nenin 61 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar nga OE i shpallur fitues, për të dhënë shpjegim për çmimet e ulëta përmes Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët.

OE i shpallur fitues, në sqarimet e dhëna për çmime jo-normalisht të ulëta, për të gjithë artikujt ka dhënë vetëm deklaratë se posedojnë pjesë rezervë në depo dhe fotografi të stoqeve, kinse do të favorizohet me furnizime nga prodhuesit dhe fabrikat, pa dhënë argumente (ndonjë ofertë, profaturë nga këta furnizues apo prodhues) se me çfarë çmime do të furnizohet, kur dihet se rabatet nga ana e prodhuesve mundën me qenë deri 10%, nuk është bashkangjitur asnjë kontratë nga tenderuesi i shpallur fitues, që është realizuar deri më tani me këto çmime jashtëzakonisht të ulëta.

OE i shpallur fitues, me shpjegimin (arsyetimi i dhënë) për çmime jo normalisht të ulëta, se 4 nga 6 tenderët e dorëzuar kemi pasur çmime shumë të përafërta, nuk qëndron dhe i pa bazuar sepse nga kontrollimi dhe nxjerrja e mesatares së çmimeve kamë konstatuar se asnjë ofertë tjetër nuk ka këso dallime(32 artikuj (68 %) janë me çmime abnormalisht të ulët, shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (9, 20, 28, 31 41, 44, 45) janë me çmime abnormalisht të larta).

Çmimi i ofertës së OE të shpallur fitues, kuptohet është i përafërt me ofertat tjera por ka çmime abnormalisht të ulët, 32 artikuj shumë larg çmimeve mesatare nga 6 ofertat- të pakrahasueshme, kurse 7 artikuj (janë me çmime abnormalisht të larta).

Autoriteti Kontraktues pa të drejtë e pranon të mjaftueshëm shpjegimin (arsyetimi i dhënë) për çmime jo normalisht të ulëta, nga Tenderuesi i shpallur fitues, Grup i Operatorëve Ekonomik N .SH. “BF ENERGY”& “Romay Lift”SH.P.K. nga Prishtina dhe e trajton tenderin njëjtë me tenderët tjerë.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit profesional te prokurimit konstaton se pretendimet e OE ankues, "EJONA" shpk nga Peja, se Autoriteti Kontraktues ka shkelur neni 61 i LPP, pasi nuk e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, janë të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59, dhe 61 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- 1x1 OE-"EJONA" sh.p.k - Pejë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.